



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Sondazhi Kombëtar i Studentëve¹

1. Informacion për studentin (Përshkrimi rreth pyetësit dhe qëllimi)

I nderuar student!

Bazuar në Ligjin 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", ASCAL organizon Sondazhin Kombëtar të studentëve me qëllim vlerësimin e mësimdhënies dhe aspekteve të tjera në funksion të saj, në institucionin ku ju studioj.

SKS synon të japë informacion mbi situatën aktuale të arsimit të lartë në mënyrë që të ndihmojë vendimarrjen dhe politikëbërjen në fushën e arsimit për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në AL, të ndihmojë vetë institucionet e arsimit të lartë të përmirësojnë funksionimin dhe të rrisin cilësinë e tyre, të informojë me të dhëna të besueshme, studentët aktualë me cilësinë në e arsimit të lartë në institucionet ku ata studiojnë si dhe të ndihmojë studentët e rinj me informacione për cilësinë e mësimdhënies në IAL dhe programet e studimit ku ata duan të studiojnë apo të informojë publikun në tërësi për cilësinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Studentët janë pjesë e rëndësishme dhe përfituesit kryesorë të shërbimit që ofrojnë institucione dhe për këtë arsye opinioni juaj është mjaft i nevojshëm dhe do të na ndihmojë të kuptojmë më mirë se kush është situata reale në institucionin tuaj dhe se çfarë duhet përmirësuar në të.

Për këtë arsye, lutemi të plotësoni këtë pyetësor dhe dërgojeni atë kur ju të keni finalizuar përgjigjet. Data e fundit e dërgimit të pyetësit është Ju keni mundësi të shkoni pas në çdo pyetje dhe të modifikoni përgjigjet tuaja. Plotësimi i këtij pyetësi nuk do t'ju kërkojë më shumë 20 minuta kohë.

Ju lutemi të keni parasysh se ASCAL do të përdorë opinionin tuaj vetëm në këtë proces.

Ju nuk identifikoheni nëpërmjet përgjigjeve tuaja në rezultatet përmbledhëse e statistikore që publikohen në raportet përmbledhëse.

¹ Miratuar nga Bordi i Akreditimit

Gjithashtu, nëse nuk doni të merrni pjesë në këtë pyetësor mund të mos e plotësoni atë ose të ç'regjistroheni në linkun e dhënë në e-mailin e njoftimit.

Faleminderit për pjesëmarrjen në këtë pyetësor.

Stafi i ASCAL

2. Informacion i përgjithshëm:

1. Ju lutemi zgjidhni instiutuconin ku studioni: (lista e institucioneve të arsimit të lartë)
2. Ju lutemi zgjidhni llojin e programit të studimit (dipl 2 vj, bsc, dind, msc, mp, spa dr)
3. Programi ku aktualisht ju studjoni ishtë zgjedhja juaj e: (parë, dytë, tretë, katërt, e pestë)

Vlerësimi/ Miratimi / dakortësia në lidhje me opinionin e dhënë:

- a) Pa përgjigje
- b) Aspak
- c) Fare pak
- d) As pro as kundër
- e) Dakord
- f) Plotësisht dakord

Fushat e organizimit të Sondazhit kombëtar të studentëve	Kategoritë e pyetjeve sipas specifikave	Lista e pyetjeve
1. Organizimi i institucionit, menaxhimi dhe funksionimi i tij	Organizimi institucional	<ol style="list-style-type: none"> 1. Organizimi aktual i institucionit është i përshtatshëm dhe në funksion të mësimdhënies dhe studentëve (koment shpjegim i detajuar) 2. Njësitë akademike, administrative dhe ndihmëse janë të mjaftueshme për kryerjen e të gjitha proceseve të nevojshme akademike, shkencore e sociale të institucionit (koment shpjegim i detajuar) 3. Institucioni ka ngritur struktura/ njësi të posaçme në shërbim të studentëve
	Menaxhimi dhe administrimi	<ol style="list-style-type: none"> 4. Organet drejtuese tregojnë interes të vazhdueshëm ndaj jush dhe kërkesave tuaja (koment shpjegim i detajuar, rektorati, dekanati), 5. Fakulteti/Departamenti administrojnë në mënyrë korrekte procesin mësimor 6. Zyrat e shërbimit për studentët mbështesin vazhdimisht studentët gjatë gjithë vitit akademik
	Bashkëpunimi	<ol style="list-style-type: none"> 7. Institucioni ofron mundësi të mjaftueshme bashkëpunimi për studentët si brenda institucionit ashtu edhe me institucionet e tjera (koment shpjegim i detajuar, brenda dhe jashtë vendit) 8. Institucioni ju mundëson mobilitet dhe bashkëpunim në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit në universitete të tjera 9. Lista dhe numri i institucioneve që ju janë rekomanduar si dhe profili i tyre, janë të mjaftueshëm për realizimin e praktikave mësimore dhe profesionale
	Vendimarrja	<ol style="list-style-type: none"> 10. Vendimarrja e organeve kolegjiale dhe drejtuese (koment shpjegim i detajuar, senat, bordi i administrimit, rektorat, dekanat etj) bëhet publike 11. Studentët janë të përfshirë plotësisht në vendimarrjen e institucionit 12. Dokumentet themelore të institucionit, ndryshimet, programet, raportet e ndryshme, diskutohen vazhdimisht me studentët, (koment shpjegim i detajuar)

	Transparenca	<p>13. Informacionet zyrtare publikohen në kohë reale në faqen e internetit dhe në standat e institucionit, (koment shpjegim i detajuar)</p> <p>14. Studentët kanë mundësi për të konsultuar dokumentacionin e institucionit</p> <p>15. Kriteret, procedurat dhe përzgjedhja e stafit akademik dhe studentëve publikohen vazhdimisht</p> <p>16. Kriteret, procedurat dhe përzgjedhja e studentëve publikohen vazhdimisht</p>
2. Burimet në funksion të mësimdhënies	Infrastruktura fizike	<p>17. Institucioni ka hapësira të mjaftueshme për realizimin e procesit mësimor, (koment shpjegim i detajuar)</p> <p>18. Institucioni ka hapësira të mjaftueshme çlodhje, sportive dhe argëtimi</p> <p>19. Ambientet e brendshme të institucionit janë funksionale të pajisura me logjistikën e nevojshme, (koment shpjegim i detajuar)</p> <p>20. Ambientet e institucionit janë të pajisura me ndriçim, izolim dhe sisteme ngrohje/ftohje</p> <p>21. Ambientet e institucionit janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht</p>
	Infrastruktura didaktike/logjistike	<p>22. Ju informoheni vazhdimisht për infrastrukturën logjistike e didaktike që ekziston në institucionin tuaj (koment shpjegim i detajuar)</p> <p>23. Ju mund të konsultoni llogarinë tuaj në sistemin informatik që ofron institucioni (koment shpjegim i detajuar, dokumente, nota etj)</p> <p>24. Infrastruktura e IT (PC, Internet, Wi-Fi) është në nivelin e duhur dhe ju ndihmon mjaftueshëm në procesin mësimor</p> <p>25. Libraria (fizike dhe elektronike) dhe hapësirat e studimit ju ndihmojnë mjaftueshëm në procesin mësimor</p> <p>26. Ju shfrytëzoni infrastrukturën dhe laboratorët kur keni nevojë (koment shpjegim i detajuar, për detyra kursi, diploma, studime)</p>
	Stafi akademik	<p>27. Stafi akademik është i disponueshëm dhe lehtësisht i kontaktueshëm</p> <p>28. Në programin tuaj profesorët nuk japin më shumë se dy lëndë të ndryshme (koment shpjegim i detajuar)</p> <p>29. Profesorët ju mbështesin vazhdimisht për tu angazhuar në projekte, studime dhe mobilitete (koment shpjegim i detajuar, erasmus, etj)</p>

	Kapacitetet administrative / finaciare	<p>30. Institucioni mbështet financiarisht aktivitetet e Qeverisë Studentore</p> <p>31. Institucioni ve në dispozicion infrastrukturën e institucionit në funksion të Qeverisë Studentore</p> <p>32. Institucioni ju mbështet financiarisht (koment shpjegim i detajuar, bursë e plotë, e pjesshme, mbulim shpenzimesh në aktivitete)</p>
3. Kurrikulat, përmbajtja dhe përditësimi	Organizimi i programeve	<p>33. Programi është ndërtuar në përputhje me profesionin e ardhshëm që doni të ushtroni</p> <p>34. Lëndët dhe syllabuset ofrojnë njohuri të thelluara dhe koncepte të plota</p> <p>35. Ju informoheni vazhdimisht mbi përmbajtjen e programit dhe ndryshimet e tij</p>
	Shpërndarja e veprimtarive mësimore	<p>36. Ngarkesa mësimore dhe oraret janë të shpërndara në mënyre korrekte dhe të përballueshme nga studentët</p> <p>37. Veprimtaritë mësimore (leksione, seminare, laboratore, detyra kursi, praktikë dhe punë individuale) zhvillohen në përputhje me planin mësimor</p> <p>38. Praktikat profesionale janë të shpërndara gjatë gjithë programit dhe ndihmojnë studentët për zbatimin e njohurive teorike</p>
	Literatura	<p>39. Literatura bazë janë botime / përshtatje të pesë viteve të fundit</p> <p>40. Literatura bazë përbëhet kryesisht nga botime të autorëve ndërkombëtarë</p> <p>41. Literatura bazë e ofruar kryesisht janë botime të profesorëve të lëndëve</p> <p>42. Literatura bazë dhe ndihmëse gjenden në bibliotekën e institucionit</p> <p>43. Libraria <i>on-line</i> ofron një numër të madh botimesh në fushën e studimeve tuaja</p>
4. Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi	Mësimdhënia / mësimnxënia	<p>44. Stafit akademik është mjaft kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve</p> <p>45. Stafit akademik përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit (koment shpjegim i detajuar)</p> <p>46. Stafit akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin</p> <p>47. Institucioni ve në dispozicion të mësimdhënies platforma <i>on-line</i> (<i>e-learning</i>)</p> <p>48. Stafit akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave</p>

	<p>Vlerësimi dhe transpareca</p>	<p>49. Procedura dhe kriteret e vlerësimit / notës bëhen të qarta në fillim të lëndës 50. Vlerësimi dhe notat e marra kanë qënë korrekte 51. Kontrolli i provimeve dhe rezultatet jepen në kohë 52. Testimet dhe vlerësimet gjithjeh realizohen me komisione 53. Komentet e bëra në kontrollin e provimit më kanë ndihmuar të kuptoj gabimet dhe zgjidhjen e saktë të tyre 54. Plagjiatura apo kopjimi në provime dhe detyra, nuk tolerohen nga stafi akademik 55. Shokët tuaj kanë përfituar nota më të larta në këmbim të favoreve ndaj profesorëve 56. Në ndonjë rast, ju nuk jeni vlerësuar mjaftueshëm në provime nga profesorët tuaj 57. Në ndonjë rast, Ju keni përfituar notë/ vlerësim më të lartë nga ai që meritoni 58. Kërkesa për rishikimin e testit dhe vlerësimit të studentëve merret parasysh nga komisioni i provimit</p>
	<p>Kompetencat</p>	<p>59. Kompetencat/ aftësitë janë të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde 60. Në përfundim të çdo ore mësimi apo lënde, profesorët vënë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre 61. Stafi akademik realizon orë të hapura/seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë 62. Mësimdhënia është realizuar mbi bazë kompetencash dhe ju ka dhënë mundësi zhvilloni njohuritë e marra në laboratore dhe praktikat profesionale 63. Stafi akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup</p>
<p>5. Aktiviteti kërkimor, projekte studime, botime</p>	<p>Studime dhe analiza Kërkime Botime, publikime aktivitete dhe projekte</p>	<p>64. Stafi akademik dhe institucioni ju inkurajon dhe mbështet studentët të përfshihen në aktivitete studimore, seminare 65. Juve ju mundësohen mjetet e duhura logjistike e laboratorike për të kryer analiza dhe studime të thelluara 66. Udhëheqësit / tutorët ju asistojnë dhe mbështesin studentët gjatë realizimit të temave të diplomave 67. Studentët të publikojnë punime dhe artikuj në faqen e zyrtare të institucionit dhe në revistat/buletinet e botuar prej tij 68. Studentët organizojnë konferenca brenda dhe jashte vendit me financime te institucionit</p>

6. Studentët dhe mbështetja e tyre	Regjistrimi dhe administrimi	<p>69. Informacioni paraprak i publikuar ishte mjaft i dobishëm në përzgjedhjen e institucionit</p> <p>70. Nëse do të kisha edhe njëherë mundësi regjistrimi, do të zgjidhja të njëjtin program studimi</p> <p>71. Procedurat e regjistrimit, të drejtat dhe detyrimet ishin të qarta dhe mu vunë në dispozicion paraprakisht</p> <p>72. Institucioni ju ofron mundësi të pagesës me këste ose asistencë në fitim e një kredie studenti</p> <p>73. Institucioni ju informon për akomodimin tuaj gjatë studimeve</p> <p>74. Institucioni ju ndihmon për akomodimin tuaj gjatë studimeve</p>
	Studenti në IAL	<p>75. Institucioni ju ofron kartën e studentit me të cilën përfitoni transport dhe çmime të reduktura në institucione publike e private</p> <p>76. Institucioni ju ofron siguracion/ asistencë shëndetësore/sociale brenda dhe jashtë ambienteve të tij</p> <p>77. Tutoriati dhe koordinatorët ju informojnë vazhdimisht mbi të rejat dhe ndryshimet në institucion</p> <p>78. Zëri i studentëve nëpërmjet këshillave studentore dëgjohet dhe pasqyrohet në vendimmarrjen e institucionit</p> <p>79. Institucioni ofron mundësi, mobilitet dhe transferimi në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit</p> <p>80. Studentët e kategorive në nevojë mbështeten dhe bëhen pjesë integrale e institucionit</p> <p>81. Studentët mbështeten në aktivitetet e tyre humane, sociale e sportive</p>
	Punësimi	<p>82. Zyra e karrierës jep informacion mbi tregun e punës, orientimin dhe ofertat e punësimit</p> <p>83. Zyra Alumni-t/ diplomuarve jep informacione mbi historikun e punësimit të studentëve të diplomuar dhe eksperiencat e tyre</p> <p>84. Institucioni bashkëpunon me kompani të ndryshme dhe biznese të cilët ofrojnë praktika dhe mundësi punësimi</p>

4. Vlerësimi i përgjithshëm

1. Institucioni i ka përmbushur pritshmëritë e mia (po/jo)
2. Ju lutemi rendisni duke filluar nga pika më e fortë (5) tek ajo më e dobët (1) këto indikatorë të përgjithshëm të institucionit:

·	Funksionimi i institucionit, vendimmarrja dhe transparenca	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
·	Infrastruktura e institucionit	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
·	Stafi akademik dhe administrativ	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
·	Programet e studimit	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
·	Metodat e mësimdhënies	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
·	Kërkimin shkencor	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
·	Mbështetja ndaj studentëve dhe punësimi	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>